



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kryeministri

U R D H Ë R

Nr. 3, datë 8.1.2009

PËR

KRIJIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË BARAZISË GJINORE

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr.9970, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri", me propozimin e ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta,

U R D H Ë R O J :


1. Krijimin e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, si organ këshillimor për drejtimin, përcaktimin dhe zhvillimin e politikave shtetërore për barazinë gjinore.
2. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore të kryesohet nga ministri, që mbulon çështjet e barazisë gjinore, dhe të ketë në përbërje këta anëtarë:
 - a) Zëvendësministrin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;

- b) Zëvendësministrin e Integritit;
 - c) Zëvendësministrin e Financave;
 - ç) Zëvendësministrin e Drejtësisë;
 - d) Zëvendësministrin e Brendshëm;
 - dh) Zëvendësministrin e Arsimit dhe Shkencës;
 - e) Zëvendësministrin e Shëndetësisë;
 - ë) Zëvendësministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
 - f) Zëvendësministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
3. Ministri, që mbulon çështjet e barazisë gjinore, kryetar i Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, propozon dy përfaqësues të institucionit të tij/saj, për në këtë këshill, duke përcaktuar preferencën e parë dhe të dytë për kandidatin, si dhe duke marrë parasysh zbatimin e parimit të përfaqësimit të barabartë, sipas përkatësisë gjinore.
 4. Ministri, që mbulon çështjet e barazisë gjinore, përzgjedh dhe emëron përfaqësuesin e shoqërisë civile dhe të shoqatës, anëtar të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, në bazë të një procedure konkurrimi të hapur, sipas kriterëve, që vlerësojnë angazhimin e tij në çështjet e barazisë gjinore.
 5. Në mbështetje të propozimeve të ministrit dhe të përzgjedhjes së bërë për përfaqësuesin e shoqërisë civile/organizatës jofitimprurëse, ministri, që mbulon çështjet e barazisë gjinore, bën emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, përfaqësues të ministrive dhe të shoqërisë civile/organizatës jofitimprurëse, të përcaktuara në pikën 2, të këtij urdhri, duke marrë parasysh zbatimin e parimit të përfaqësimit të barabartë, sipas përkatësisë gjinore.
 6. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me nenet 11 e 12, të ligjit nr.9970, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri", dhe rregullat procedurale të funksionimit të këtij këshilli janë përcaktuar në rregulloren përkatëse.

7. Ngarkohen ministritë e përcaktuara në pikën 2, të këtij urdhri, që, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e tij, të dërgojnë emrat e përfaqësuesve të tyre në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Sali Berisha', written over a horizontal line.

SALI BERISHA